

URDHËR
Nr. 261, datë 25.8.2022

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM TË KOMPETENCAVE

Në zbatim të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative, të VKM-së nr. 58, datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, nenit 26, të rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.1015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të mëposhtme të titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave të cilat nuk delegohen dhe që janë të shprehura me ligj, drejtorit të Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrimit Qendror, z. Agron Cani.

2. Z. Agron Cani i delegohen kompetencat si më poshtë:

- ndjek dhe zbaton rregulloren “Për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar” (i ndryshuar);
- ndjek dhe monitoron prezencën në punë të personit të DSIK-së;
- ndjek detyrat e vendosura në planin mujor;
- merr dhe trajton korrespondencën shkresore.

3. Kompetencat e mësipërme delegon për periudhën nga data 26.8.2022 deri më 31.8.2022.

4. Z. Agron Cani nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrimit Qendror.

6. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

7. Ky urdhër hartohet në 2 (dy) kopje të njëjta, një për Protokoll-Arkivin dhe një për drejtorin e Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrimit Qendror.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Dorian Tola